

Bashkia: PRRENJAS

Kryetar: MIRANDA RIRA

Fusha: INFRASTRUKTURË DHE SHËRBIME PUBLIKE

Premtime:

1. Do të rikonstruktohet zona pranë liqenit dhe do të krijohet një shëtitore
2. Do të krijohet një park autobusësh për të gjitha zonat
3. Do të kryhet rikonstruksion i rrjetit të ujit të pijshëm dhe të ujërave të zeza si dhe ndërtimi i një impianti për pastrimin e ujërave të zeza në territorin e bashkisë (fond 1 milion euro, projekt zviceran dhe i qeverisë gjermane) i cili fillon zbatimin në shtator 2015 dhe do të përfundojë brenda dy viteve të para të mandatit
4. Do të zgjidhet problemi i regjistrimit të tokave në territorin e bashkisë
5. Do të rikonstruktohet rruga “Gjorg Golemi” nga zyrat e kromit deri tek lagja e Karriqit
6. Do të rikonstruktohet rruga e lagjes së Karriqit nga kabina elektrike deri tek kompresorët
7. Do të rikonstruktohet rruga “22 Shkurti” nga rruga nacionale tek kompresorët
8. Parashikohet ndërhyrje në rrugën Prrenjas-Rashtan, Prrenjas-Pishkash Veri-Skroske, Rrajcë- Sutaj, Kotodesh, Gurre, Qukes, Skenderbe, Stravaj, etj.
9. Do të kryhet ndërtimi KUZ (ujësjellës, ndërtimi i kanalizimeve dhe kolektorëve të ujërave të zeza dhe të bardha) në lagjet: “Kodra e Karriqit”; Lagja e “Kromit”; Lagja e “Bitumit dhe tek Depo e ujit”
10. Do të kryhet rikonstruksion i rrugëve të brendshme të fshatit nga Kompresorët deri tek lagja “Branicë”
11. Do të kryhet rikonstruksion i qendrës së fshatit dhe ndërtimi i kanalizimeve në lagjen e “Karriqit”
12. Do të kryhet rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës Prrenjas-Rashtan me gjatësi 5.5 km (nga ura e Fshatit Përrenjas deri tek varrezat, shkolla e vjetër Rashtan)
13. Do të kryhet rikonstruksion i rrugëve të brendshme dhe ndërtimi i qendrës shëndetësore në lagjen “Zhavare”
14. Do të kryhet urbanizimi i qytetit të Prrenjasit
15. Do të rikonstruktohet bulevardi në qytetin e Prrenjasit
16. Do të kryhen investime në infrastrukturën rrugore në Mënik
17. Do të kryhen investime në infrastrukturë rrugore në fshati Dritaj
18. Do të kryhen investime në infrastrukturë rrugore në fshatin Katjel

Fusha: ARSIM/KULTURË/SPORT

Premtime:

1. Do të mbështetet financiarisht ekipi i futbollit të bashkisë

2. Do të rikthehet shkolla profesionale, që do të ndihmojë në përgatitjen e të rinjëve për tregun e punës
3. Do të krijohet një kënd lojrash për fëmijët në territorin e bashkisë

Fusha: MJEDIS/TURIZËM

Premtime:

1. Do të ndërtohet një landfill për mbetjet në gjithë bashkinë
2. Nuk do të lejohet që të vazhdojë prerja e pyjeve, sidomos në parkun kombëtar Shebenik-Jabllanicë dhe gjithashtu në zonën e Sharrës
3. Për zhvillimin e turizmit do të realizohet një binjakëzim me komunën e Strugës duke shkëmbyer eksperiencat dhe zhvilluar projekte të përbashkëta, në mbështetje të donatorëve; Agroturizmi do të jetë një dritare shumë e rëndësishme për të promovuar prodhimin vendas, p.sh ka disa bimë që janë fitimprurëse si sherebela, dëllinja e zezë.

Fusha: BUJQËSI

Premtime:

1. Do të jepen grante që ndihmojnë bizneset, për të gjithë ata që duan të mbjellin vreshta
2. Do të jepen grante në blegtori për të gjithë ata që duan të hapin një baxho për të mbledhur produktet e zonës
3. Do të kryhet rikonstrukcion i sistemit të vaditjes (Prrenjas-Rashatan)

Fusha: TRANSPARENCA

Premtime:

1. Do të ngrihet një agjenci për konsulencën me komunitetin, e cila do të përbëhet nga intelektualë e biznesmenë të 4 njësive bazë

Fusha: SHËRBIMET SOCIALE

Premtime:

1. Në Këshillin Bashkiak 50 % do të jenë femra
2. Do të ngrihet një qendër sociale për moshën e tretë

Fusha: EKONOMI DHE PUNËSIM

Premtime:

1. Do të hapen biznese fason për të punësuar kryesisht gratë
2. Do të punohet për të vënë në punë minierat për të hapur vende të reja pune
3. Do të krijohet një park logjistik ku të gjitha mallërat që vijnë nga Durrësi të parkojnë në Prrenjas, gjë e cila sjell të ardhura ekonomike për bashkinë